



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- **Aktivitetet e përgjithshme**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**
- * **Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial**

Tetor 2022

Aktivitetet e përgjithshme

Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Akademisë së Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë

Me datë 02 Tetor 2022, Akademia e Drejtësisë nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet me qëllim të rritjes dhe thellimit të bashkëpunimit në mes Akademisë së Drejtësisë të Kosovës dhe Shkollës së Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë në lëmin e organizimit të aktiviteteve të përbashkëta për zhvillimin dhe avancimin cilësor profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe përfituesve tjerë ligjor të të dyja vendeve.

Të dy institucionet duke njohur vlerën e rëndësishme të bashkëpunimit në arsimim të vazhdueshëm në fushën e zbatimit të ligjit, kanë

vendosur që të krijojnë bazë të përshtatshme për bashkëpunim të ardhshëm në disiplinat e përbashkëta për të dy institucionet.

Dy institucionet deklaruan përkrahjen dhe gatishmërinë e tyre për të kontribuar në rritjen e lidhjeve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore me dobi të përbashkët.

Gjithashtu, Drejtori Ekzekutiv i AD-së, Enver Fejzullahu dhe U.D. Drejtori i Administratës dhe Financave të AD-së, Faton Fetoshi, morrën pjesë edhe në ceremoninë e organizuar me rastin e 25 vjetorit të veprimtarisë akademike të Shkollës së Magjistraturës, si dhe në Konferencën shkencore “Drejtësia Penale në Veprim”.



Akademia e Drejtësisë nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi me Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë



Me datë 04 Tetor 2022, Akademia e Drejtësisë ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë.

Memorandumi i Bashkëpunimit, i nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv i AD-së, z.Enver Fejzullahu dhe Drejtori Ekzekutiv i FDHK-së, z.

Bekim Blakaj, ka për qëllim bashkëpunimin mes Akademisë së Drejtësisë dhe Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) në organizimin e trajnimeve në fushën e krimeve të luftës dhe organizimeve të tjera të ngjashme që lidhen me ngritjen e kapaciteteve të personelit gjyqësor, që merret me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë.

Me këtë rast, z. Fejzullahu dhe z. Blakaj u zotuan se të dyja palët do të koordinojnë së bashku aktivitetet me interes të përbashkët, të cilat do të zbatohen në mirëkuptim reciprok dhe në përputhje me rregulloret dhe politikat e të dyja palëve.

Punëtori për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2023



Më datë 06 – 07 Tetor 2022, është realizuar Punëtorina për Hartimin e Programit Trajnues për vitin 2023.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte përcaktimi i Kurikulës Trajnuese për vitin 2023, në pajtim me nevojat trajnuese të gjyqtarëve, prokurorëve dhe

profesionistëve tjerë ligjor si dhe kërkesave dhe prioriteteve tjera të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Në ditën e parë Këshilli Programor bashkë me kryeprokurorët e prokurorive kanë identifikuar temat përkatëse për prokurorë dhe kurrikulën trajnuese të nevojshme ndërkaq në ditën e dytë ngjashëm kanë vepruar edhe e kryetarët e gjykatave.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin Kryetarët e Gjykatave, Kryeprokurorët, Anëtarët e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë, Kryetari i Komisionit për trajnime nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës si dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë nga radhët e Departamentit të Programit

Takim me institucionet e sistemit të drejtësisë për prezantimin e të gjeturave nga vlerësimi i nevojave për trajnim për krimin e rëndë dhe të organizuar

Me 19 tetor 2022, në mbështetje të iniciativës Chemonics për Sundim të Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI), projekt ky i financuar nga Mbretëria e Bashkuar është realizuar takimi i përbashkët me gjyqtarë dhe prokurorë si dhe zyrtarë policor që merren me rastet e krimit të organizuar dhe krimet e rënda.

Takimi kishte si qëllim prezantimin e të gjeturave nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese i cili është realizuar në mbështetje të Chemonics paraprkisht nga muaji gusht deri në shtator të vitit 2022 dhe përcaktimi dhe zbatimi i kurrikulës trajnuese për krimin e organizuar dhe krimet e rënda i cili do të adresoi problemet praktike të akterëve relevant që merren me rastet përkatëse.

Bazuar në rezultatet nga takimet me fokus grupet e gjyqtarëve që ishin nga radhët e departamentit special, prokurorëve nga PRSK si dhe hetues nga Policia e Kosovës konfirmohen sfida dhe vështirësi të theksuara të cilat për shkak të natyrës komplekse të rasteve shkaktojnë gabime procedurale, të cilat më pastaj vihen në pah kryesisht nga gjykatat. Po ashtu është konfirmuar mungesa e bashkëpunimit që determinon në hetime të dobëta, prezantim të dobët të rasteve e gjithashtu edhe strategji të varfër të dënimit. Në vijim është vu në pah edhe mungesa e prak-


tikës së unifikuar që vjen si rezultat i mungesës së opinionëve ligjore duke shkaktuar kështu një mjedis ligjor sfidues.

Sa i përket trajnimeve u tha që mungesa e trajnimit nuk është shkak kryesor i dështimit të rasteve megjithatë kërkohet qasje e re si brenda programit të trajnimit, ashtu edhe përtej mësimit të madhe për të çuar bashkëpunimin në hetime në një nivel më të lartë.

Të gjithë pjesëmarrësit në takim e konfirmuan nevojën për një kurrikulë trajnuese që do të adresoi mangësitë e theksuara të identifikuara gjatë këtij procesi përmes tryezave dhe ekipeve të përbashkëta dhe me pjesëmarrjen e ekspertëve veçanërisht nga Britanija e Madhe për të zbatuar praktikatat më të mira në këtë fushë.

Pjesëmarrës në këtë takim ishte gjyqtari mbikëqyrës në Departamentin Special i Apelit, Kryeprokurori i Shtetit, U.D kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Përfaqësues nga Policia e Kosovës, Kryetari i Komisionit për trajnime në KGJK si dhe stafi i AD-së dhe nga projekti i Chemonics.

Takim me Administrator të Gjykatave dhe Prokurorive për Vlerësimin e nevojave trajnuese për Hartimin e Programit Trajnues të vitit 2023



Më datë 20 Tetor 2022, janë realizuar dy takime online për mes platformës zoom për vlerësimin e nevojave trajnuese për stafin administrative të gjykatave dhe prokurorive. Paradite takimi u realizua me Administrator të Gjykatave ndërsa pas dite takimi u realizua me Administrator të Prokurorive.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte përcaktimi i Kurikulës Trajnuese për vitin 2023, në pajtim me nevojat trajnuese të bashkëpunëtorëve profesional, zyrtareve ligjor dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Në kuadër të këtyre takimeve u prezantuan trajnimet të cilat janë realizuar gjatë këtij viti për bashkëpunëtorët profesionale dhe stafin administrativ si dhe u identifikuan nevojat për Programin Trajnues për vitin 2023.

Pjesëmarrës në këto takime ishin: administratorët, ndihmës administratorët e gjykatave dhe prokurorive si dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë nga radhët e Departamentit të Programit.

Trajnimi në EJTN në temën: “Liria e shprehjes në Epokën Digjitale”

20-21 tetor 2022, nën organizimin e Rrjetit Evropian për Trajnime Gjyqësore (EJTN), përmes Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, në Zagreb të Kroacisë, u mbajt trajnimi në temën: “Liria e shprehjes në Epokën Digjitale”.

Me përkrahjen financiare të Gjykatës Kushtetuese, në këtë trajnim morën pjesë edhe zyrtarët e Gjykatës: Këshilltari i lartë kushtetues-juridik, Nexhat Kelmendi dhe Drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim (ZKI), Veton Dula.

Trajnimi dy-ditor i filloi punimet me testimin e njohurisë profesionale të pjesëmarrësve përkritazi me aspekte të ndryshme të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), si dhe me pyetje të natyrës logjike në fushën e lirisë së shprehjes.

Gjatë ditës së parë të trajnimit, të gjithë pjesëmarrësit patën mundësinë që të informohen më për së afërmi me disa raste konkrete, të trajtuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), që për objekt të çështjes kishin lirinë e shprehjes dhe zbatimin e nenit 10 (Liria e Shprehjes) të KEDNJ-së.

Dita e dytë e trajnimit ndërkaq në fokus pati lirinë e shprehjes në rrjete sociale dhe në internet, si dhe keqpërdorimin e kësaj të drejte në raste të caktuara nga individë të ndryshëm, por edhe nga vetë mediat elektronike (portalet). Temë e diskutimit dhe si shembull praktik në këtë aspekt ishte edhe e drejta e përdorimit të rrjeteve sociale nga gjyqtarët, komentimi në media i rasteve në shqyrtim dhe takimet miqësore të gjyqtarëve me palët në procedurë.

Pjesë e trajnimit dy-ditor ishte edhe ndarja e të gjithë pjesëmarrësve në dy grupe punuese, të cilat së bashku me trajnerët e përzgjedhur trajtuan dhe shqyrtuan raste të ndryshme nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, që për objekt të çështjes kishin lirinë e shprehjes dhe nenin 10 të KEDNJ-së.

Trajnimi dy-ditor u përmbyll me përsëritjen e testimit të ditës së parë, për të matur njohuritë e përfituara të të gjithë pjesëmarrësve nga trajnimi i mbajtur.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Trajnimi fillestarë për gjyqtarët e sapo emëruar, grupi I-gjenerata (IX)



Gjatë muajit tetor për grupin e I të gjyqtarëve të sapo emëruar (29), gjenerata e IX janë realizuar gjithësejt 42 sesione trajnimi nga modulet: Kodi i Procedurës Penale, Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese, Rendi Juridik kombëtar dhe ndërkombëtarë dhe nga nën modulet përkatëse.

Në kuadër të modulit: Kodi i Procedurës Penale janë realizuar 2 sesione trajnuese nga nën moduli “Procedura e kryesve me çrregullime mendore” me ç’rast janë trajtuar: shqiptimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe paraburgimi i kryesve me çrregullime mendore.

Nga nën moduli “Procedurat sipas mjeteve juridike” janë realizuar 3 sesione të cilat kanë përfshirë mjetet e rregullta juridike, bazat ankimore për ushtrimin e ankesës dhe mjetet e jashtëzakonshme.

Nga nën moduli “Aktgjykimi dhe llojet e tij” janë realizuar 3 sesione me ç’rast janë trajtuar: vendimet gjyqësore në procedurën penale, aktvendimi dënues dhe aktgjykimi lirues.

Nga nën moduli: “Shqyrtimi gjyqësor” janë realizuar 4 sesione me fokus te: shtyrja ndërprerja dhe koha e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, rrjedha e shqyrtimit gjyqësor, paraqitja e prov-

ave dhe fjala përfundimtare si dhe procedura e marrjes në pyetje dhe shpallja e aktgjykimit.

Në kuadër të nën modulit: “Provat në procedurën penale” janë realizuar 4 sesione ku janë trajtuar: kuptimi dhe llojet e provave në procedurën penale, provat sipas Kodit të Procedurës penale, ekspertimi dhe masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit dhe llojet e tyre si prova dhe kontrollimi këqyrja dhe kërkesat kombëtare, provueshmëria dhe pranueshmëria e tyre.

Në kuadër të nën modulit: “Procedurat e veçanta sipas KPPK” janë realizuar 3 sesione dhe janë trajtuar: procedurat ndaj personave të cilët kanë kryer vepër penale në ndikim të alkoolit dhe drogës, ku përfshihen edhe kryesit me çrregullime mendore, paraburgimi dhe procedura me revokimin e dënimeve alternative.

Në kuadër të nën modulit: “Procedurat alternative” janë realizuar 2 sesione prej të cilëve janë trajtuar: procedurat alternative dhe kushtet kur ndjekja nuk është e detyrueshme.

Në kuadër të nën modulit: “Shpenzimet e procedurës penale” është realizuar një sesion ku është trajtuar: shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesat pasurore juridike.

Nga moduli: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese, janë realizuar 2 sesione nga nën moduli “Ligji për kundërvajtje”, në kuadër të cilave janë trajtuar: vepra penale e kundërvajtës dhe aktgjykimi mbi kundërvajtjen, organet për paraqitjen e kundërvajtjes, aktgjykimet, aktvendimet dhe mjetet juridike.

Nga nën moduli: “Kodi i drejtësisë për të mitur” janë realizuar 4 sesione nga të cilat janë trajtuar: shqiptimi i masave dhe dënimeve madhore për veprat penale të kryera si të mitur, masat edukuese ndaj të miturve, vendimet gjyqësore, mjetet juridike, gjykimi madhorë i veprave penale i kryer ndaj të miturve dhe dispozitat e përgjithshme që e karakterizojnë veprën penale të kryer nga të miturit, parimet e procedurës dhe kompetencat e gjykatave.

Nga moduli Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar janë realizuar 9 sesione trajnuese nga nën moduli “KEDNJ” nga i cili janë trajtuar: GJEDNJ dhe Konventa Evropiane, Neni 2 i Konventës Evropiane, Neni 5 par. 1 prezumimi

në favor të lirisë, garancitë procedurale në rastet e heqjes së lirisë, Neni 6 i KDENJ, Neni 10 Liria e shprehjes, KEDNJ-Liria e shprehjes mbrojtja e gazetarëve dhe KDND Liria e shprehjes mbrojtja e sinjalizuesve.

Nga nën moduli: Bashkëpunimi juridik Ndërkombëtar janë realizuar 2 sesione me ç’rast janë trajtuar bashkëpunimi juridik në çështje civile dhe penale.

Metodologjia e zhvillimit të trajnimit është zbatuar me raste praktike duke trajtuar shembuj dhe me anë të metodës së bashkëbisedimit.



Trajnimi fillestarë për gjyqtarët e sapo emëruar, grupi II-gjenerata (IX)



Gjatë muajit tetor për grupin e dytë të gjyqtarëve të sapo të sapo emëruar (18), gjenerata e IX janë realizuar gjithsejtë 42 sesione trajnimi teorik nga modulet: E drejta civile, administrative dhe ekonomike, Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, Shkathësitë personale dhe ndërpersonale, dhe Kodi penal.

Në kuadër të modulit: E drejta civile, administrative dhe ekonomike është realizuar 1 sesion trajnuese nga nën moduli “ E drejta e familjare ” me fokus te dhuna në familje. Nga nën moduli “E drejta administrative ” janë realizuar 9 sesione trajnuese në kuadër të cilave janë trajtuar: Fillimi i procedimit administrativ, procedimi administrativ deri në nxjerrjen e aktit administrativ, akti administrativ, mjetet juridike, ekzekutimi i vendimit përfundimtar administrativ, konflikti administrativ, padia në konfliktin administrativ, procedura paraprake në konfliktin administrativ dhe seanca e shqyrtimit kryesor, dhe aktgjykimi dhe mjetet juridike në konfliktin administrativ.

Nga nën moduli “ E drejta e punës ” janë realizuar 5 sesione trajnuese me fokus te themelimi i marrëdhënies së punës (Ligji i Punës dhe Ligji i për Zyrtarë Publik), kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit te punës, kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit për zyrtar publik, mbrojtja në punë dhe kompensimi i dëmit të shkaktuar në punë.

Nga nën moduli “ E drejta trashëgimore ” janë realizuar 4 sesione trajnuese në kuadër të cilave u trajtuan: trashëgimia në bazë të ligjit dhe rradhët trashëgimor, trashëgimia në bazë të testamentit, pjesa e domosdoshme, cenimi i pjesës së domosdoshme, padenjësia dhe përjashtimi nga trashëgimia dhe kalimi i pasurisë trashëgimore të trashëgimtarët.

Nga nën moduli “ E drejta ekonomike ” janë realizuar 9 sesione trajnuese me fokus te: E drejta ekonomike –shoqëritë tregtare, kontratat në ekonomi, punët bankare dhe sigurorese, kontrata e kredisë, kontratat e sigurimit-kompensimi i dëmit, kontratat e ndërtimit, efektet e shkëputjes së kontratës, të drejtat e pronësisë intelektuale, zgjidhja alternative e kontesteve, dhe falimentimi.

Në kuadër të modulit Rendi Juridik kombëtar dhe ndërkombëtarë janë realizuar 2 sesione trajnuese nga nën moduli “ KEDNJ ” me theks te: Roli dhe rëndësia e këshillit të Evropës, Gjykata evropiane e të drejtave të njeriut dhe Konventa evropiane për të drejtat e njeriut.

Nga nën moduli “ Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje civile ” është realizuar 1 sesion trajnues dhe nga nën moduli “ E drejta e BE -së ” janë realizuar 2 sesione trajnuese me theks te: Roli dhe kompetencat e institucioneve të bashkimit evropian, burimet e së drejtës së bashkimit evropian.

Në kuadër të modulit Shkathësitë personale dhe ndërpersonale janë realizuar 4 sesione trajnuese nga nën moduli “ Arsyetimi i vendimeve gjyqësore në lëmin civile ” me ç ‘rast janë trajtuar: Procesi dhe parimet e të shkruarit mirë, shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore në fushën civile përmes metodës IRAC, interpretimi dhe arsyetimi ligjor dhe struktura dhe përmbytja e arsyetimit të aktgjykimit.

Në kuadër të modulit Kodi Penal është realizuar 1 sesion trajnues nga moduli “ Kodi penal-pjesa e përgjithshme ” me fokus te Nocioni dhe elementet e veprës penale, ndërkaq nga nën moduli “ Kodi penal-pjesa e veçantë ” janë realizuar 3 sesione trajnuese me fokus te Veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe veprat penale kundër ekonomisë.

Metodologjia e trajnimit për këtë grup është realizuar me anë të metodës së bashkëbisedimit si dhe me anë të rasteve praktike.



Trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e IX)

Për 6 prokurorët e sapo emëruar janë zhvilluar aktivitete në drejtim të përmbushjes së programit të trajnimit teorik dhe trajnimit praktik.

Gjatë muajit tetor janë realizuar gjithsej 18 sesione trajnimi nga modulet: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale dhe Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale si dhe nga nën modulet përkatëse.

Nga nën moduli: “Kodi Penal-pjesa e përgjithshme” janë realizuar 6 sesione trajnuese me ç’rast janë trajtuar çështjet si: shtytja, marrëveshja për të kryer veprën penale, sanksionet penale për dënimet kryesore, dënimet plotësuese dhe parashkrimi.

Nga nën moduli: “Kodi Penal-pjesa e veçantë” janë realizuar 8 sesione trajnuese nga të cilat janë trajtuar veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës dhe integritetit seksual, veprat penale kundër martesës dhe familjes, kundër shëndetit publike dhe narkotikëve, veprat penale kundër ekonomisë, veprat penale të kapitullit XXVI, veprat penale

kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë dhe ndotja degradimi ose shkatërrimi i mjedisit.

Nga moduli Kodi i Procedurës Penale janë realizuar 3 sesione ku janë trajtuar: kallëzimi penal, burimet tjera të kallëzimi penal dhe hudhja e kallëzimit penal.

Nga moduli për Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale është realizuar 1 sesion trajnues për Etikën profesionale dhe përgjegjësinë disiplinore” me theks te masat disiplinore.

Metodologjia e zbatuar gjatë trajnimit teorik është realizuar me raste praktike dhe metodën interaktive.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe 12 ditë trajnimi praktik në prokuroritë përkatëse konform orarit dhe kalendarit trajnues për këtë gjeneratë.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Program i Specializuar i Trajnimit-Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare-Sesioni III

Me 04-05 tetor 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtarë – Sesioni III”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me elementet e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore me rastin e hetimit dhe gjykimit të veprave përkatëse.

Në ditën e parë trajnimi u fokusua në trajtimin e çështjeve si: elementet e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, dashja si element i veprës penale të korrupsionit, çështja e realizimit apo mos realizimit të dëmit apo përfituesit, qëllimi si element për vërtetimin e veprës penale të korrupsionit, vlerësimi i provave bindëse dhe rrethanore, krijimi i figurës së veprës penale të korrupsionit me prova rrethanore, mashtrimi në prokurim si vepër penale e ndërlikuar si dhe keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar.

Në përmbyllje të ditës së parë pjesëmarrësit

patën rastin të diskutojnë edhe raste nga praktika gjyqësore në vend, rajon dhe Evropë.

Në ditën e dytë u trajtuan aspekte të rëndësishme të Konfliktit të interesit, Marrjes së ryshfetit dhe Dhënies së ryshfetit. Në vijim vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, veprave tjera penale të këtij Kapitulli, vlerësimit të provave bindëse (të drejtpërdrejta) dhe rrethanore, Krijimit të figurës së veprës penale të korrupsionit me prova rrethanore, Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar si dhe Pasojave dhe rrezikshmëritë së këtyre veprave penale.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 32 gjyqtarë, prej tyre 1 nga Gjykata e Apelit dhe 31 të tjerë nga Gjykatat Themelore të departamentit për krime të rënda, departamentit special dhe divizioni penal si dhe 4 prokuror nga Prokuroritë Themelore të Prishtinës, Pejës dhe Gjakovës.



Trajnim: E drejta për një proces të rregullt gjyqësor



Me 6 tetor 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “E drejta për një proces të rregullt gjyqësor”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me kuadrin e së drejtës për një proces të rregullt – Nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore si dhe zbatimit të saj në praktikë.

Fillimisht pjesëmarrësit u njoftuan me konceptet kryesore të Nenit 6 të KEDNJ, aspektet teorike të rregullave të këtij neni dhe kuptimin e koncepteve në praktikën e gjykatës, përkatësisht përmes analizës së rasteve konkrete ku GJEDNJ i ka formuluar dhe trajtuar konceptet kryesore.

Pjesëmarrësit në trajnim patën mundësinë e sqarimeve të nocioneve E drejta për proces të rregullt”, - “E drejtë për gjykatë”, - “E drejta për qasje në gjykatë”, - “Gjykimi në kohë të arsyeshme”, - “Parimi i sigurisë juridike”, - “Garancitë, Standardet dhe kërkesat lidhur me gjykimin në kohë të arsyeshme në procedurat penale, civile dhe administrative”.

Në vazhdim janë vënë në pah problematikat specifike që janë shtjelluar më shumë në praktikën gjyqësore, duke veçuar këtu raste nga lëmia penale, civile dhe administrative lidhur me të drejtën për proces të rregullt gjyqësor e cila

brenda saj përfshin një sërë të drejtash të cilat për kuptimin dhe interpretimin sa më të mirë të saj u zbërthyen veçmas disa nga elementet me kryesor si: E drejta për barazi para ligjit dhe para gjykatës; E drejta për gjykim nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj; E drejta për proces publik dhe të hapur; E drejta për t’u gjykuar pa vonesë të tepruar; E drejta për t’u mbrojt vetë ose përmes përfaqësuesit ligjor; Prezumimi i pafajësisë; dhe E drejta për mjete juridike, etj.

Më tej, gjatë trajnimit u elaboruan raste nga praktika gjyqësore për të cilat Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka dhënë fjalën e saj ndaj vendimeve të Gjykatës Supreme, ku janë vendosur disa nga kriteret dhe standardet e rëndësishme nga Gjykata Kushtetuese.

Në fund, trajnimi u fokusua në rastet konkrete nga GJEDNJ dhe rajoni duke konsideruar se rëndësia e tyre për Republikën e Kosovës është me rëndësi si pasojë e ngjashmërive të problemeve në fushën e zbatimit të nenit 6 në lëmin penale, civile dhe administrative.

Në trajnim pjesëmarrësit parashtruan pyetje konkrete, duke filluar nga ato në lidhje me aplikueshmërinë e kriterëve, garancioneve dhe standardeve të GJEDNJ dhe mënyrat e niveli i zbatimit të tyre në Kosovë në procedurat gjyqësore. Këto pyetje nxorën edhe një diskutim të thelluar në disa tematika me rëndësi.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 36 gjyqtarë, prej tyre 2 nga Gjykata Supreme, 5 nga Gjykata e Apelit dhe 29 të tjerë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Trajnimet: Risitë e Kodit të procedurës penale

Me 07-08 tetor 14-15 tetor si dhe 28-29 tetor 2022, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, për regjionin e Ferizajit, Pejës dhe Gjilanit janë realizuar 3 trajnime për “Risitë e Kodit të Procedurës Penale”

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte njoftimi i gjyqtarëve dhe prokurorive duke përfshirë edhe profesionistët e tjerë ligjor lidhur me Risitë e Kodit të Procedurës Penale, të cilat kanë tendencë për ndryshime të nevojshme dhe efektive.

Trajnimet u orientuan në trajtimin dhe shpjegimin sa i përket Mbrojtës së detyruar, mbrojtësit me shpenzime publike dhe kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës.

Më tej është vazhduar me hedhjen e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar aktvendimin, masat e veçanta hetimore, mbrojtja e dëshmitarëve, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake, mundësia hetuese e veçantë, hetimi (afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e hetimeve).

Trajtimi i këtyre çështjeve është bërë duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatave dhe prokurorive.

Në këtë trajnim u trajtua edhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit.

Ndër të tjera u shtjellua edhe Shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor duke u vazhduar me standardin e rishikimit të ankesave shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga Gjykata e Apelit, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, sekuestrimi dhe konfiskimi si dhe procedura penale ku përfshihen kryesit me çrregullime mendore.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar me raste praktike.

Pjesëmarrës në trajnimin dedikuar regjionit të Ferizajit ishin: 10 gjyqtarë, 10 prokurorë si dhe 4 avokatë dhe 1 mbrojtës i viktimave.

Pjesëmarrës në trajnimin dedikuar regjionit të Pejës ishin: 14 gjyqtarë, 12 prokurorë, 1 administrator si dhe 16 avokat dhe 2 mbrojtës të viktimave.

Pjesëmarrës në trajnimin dedikuar regjionit të Gjilanit ishin 7 gjyqtarë, 9 prokurorë si dhe 10 avokat dhe 2 mbrojtës të viktimave



Trajnim: Krimet e luftës

Më 11 -12 Tetor 2022, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Humanitarian Law Center Kosovo, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Krimet luftës”.

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me legjislacionin penal në tërësi në Kosovë i cili trajton veprat penale të krimeve të luftës, e po ashtu edhe legjislacionin penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale apo ligjin më të favorshëm për kryerësit e kësaj vepre penale.

Trajnimi si fillim u fokusua në shpjegimet lidhur me historikun e proceseve gjyqësore për krimet e luftës në Kosovë dhe në vazhdim edhe ligji për gjykimet në mungesë, aplikimi i ligjit penal dhe lartësia e dënimeve për krimet e luftës në Kosovë. Nga prokurorja e Kroacisë u elaborua në mënyrë të hollësishme përvoja e shtetit të Kroacisë në hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës në mungesë duke përfshirë edhe aplikimin e ligjit penal dhe lartësinë e dënimeve për krimet e luftës në Kroaci.

Vëmendje të veçantë kishte trajtimi i formave të përgjegjësive komanduese dhe përgjegjësive së ndërmarrjes së përbashkët kriminale si pretendon Zyra e Prokurorit të Specializuar për tre aktakuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit kundër gjashtë individëve në Kosovë.

Gjatë trajnimit u diskutua edhe për mundësinë e shfrytëzimit të data bazës së Tribunalit të Hagës si dhe për rastet praktike më të spikatura të cilat për pjesëmarrësit mundësojnë kuptimin më të mirë të legjislacionit që rregullon këtë fushë dhe njëkohësisht zbatimin e praktikave më të mira.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 12 gjyqtar (8 nga departamenti special dhe 4 nga departamenti për krime të rënda nga niveli themelor i Apelit dhe Gjykatës Supreme), 3 prokuror dhe 7 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë nga Prokuroria Speciale si dhe 3 zyrtarë nga Fondi për të Drejtën Humanitare.



Trajnim: E drejta ndërkombëtare për refugjatët dhe personat pa shtetësi

Më 11 Tetor 2022 në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim dhe me përkrahjen e Zyrës së UNHCR-CRP/K, është realizuar trajnimi me temë “E Drejta Ndërkombëtare për Refugjatët dhe Personat me pa shtetësi”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e aftësive të gjyqtarëve në zbatimin e legjislacionit vendor në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të azilkërkuesve, refugjateve edhe personave me pa shtetësi

Trajnimi si fillim u fokusua në shpjegimet rreth kornizës ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e refugjatëve me theks te nocionet si përkufizimi, përfshirja dhe përcaktimi i statusit të refugjatit, parimi i moskthimit, përjashtimi, ndërprerja dhe të drejtat e refugjatëve. Në vijim është vazhduar me Ligjin për azilin në Kosovë me theks te llojet e ndryshme të mbrojtjes duke vënë në pah edhe Konventën e Gjenevës për

mbrojtjen subsidiare dhe mbrojtjen e përkohshme, autoritetet e azilit në Kosovë dhe mandatet e tyre si dhe zgjidhjet e qëndrueshme dhe sidat e ndërlidhura në Kosovë.

Vëmendje të veçantë kishte edhe statusi i personave pa shtetësi, veçanërisht konceptet themelore të Konventës së vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi dhe Konventa e vitit 1961 mbi Zvogëlimin e Pa shtetësisë si dhe Ligji mbi Shtetësinë dhe Ligji i Gjendjes Civile në Kosovë me shpjegimet sa i përket autoriteteve përgjegjëse për shtetësinë në Kosovë dhe mandatet e tyre si dhe zgjidhjet të qëndrueshme dhe sfidat e ndërlidhura në Kosovë.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Në këtë trajnim përfitues ishin 15 gjyqtarë kryesisht të nivelit themelor



Trajnim: Provat elektronike në hetimet ndërkombëtare

Më 11-14 tetor 2022, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, projekti i iPROCEEDS, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi hyrës për gjyqtarët dhe prokurorët në fushën e Krimin Kibernetik dhe Provave Elektronike.

Qëllimi kryesor i trajnimit ishte rritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, dhe zyrtarëve policor në ballafaqimin dhe trajtimin e rasteve të krimeve të kryera kundër ose nëpërmjet përdorimit të sistemeve kompjuterike.

Në ditën e parë janë diskutuar njohuritë bazike të pjesëmarrësve në internet, bazat e krimin kibernetik si dhe çështjet bazike të Konventës së Budapestit dhe protokollet e saj.

Në ditën e dytë janë trajtuar provat elektronike, dispozitat themelore të Konventës së Budapestit me theks të veçantë veprat kundër identitetit, dhe veprat penale që lidhen me përmbajtjen në kompjuter.

Në ditën e tretë dhe të katërt ka qenë përmbledhje e ditës I dhe II, si dhe janë shtjelluar edhe çështjet procedurale që rrjedhin nga Konventa e Budapestit, masat mbrojtëse, bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e krimin kibernetik si dhe vështrim lidhur me hetimet e krimin kibernetik (LEA dhe/ose ndjekja).

Vëmendje e veçantë i është kushtuar legjislacionit vendor për krimin kibernetik me theks si i implementon dhe mbulon legjislacioni vendor dispozitat e Koneventes së Budapestit dhe veçanërisht me theks te mekanizmat për bashkëpunim ndërkombëtarë dhe provat elektronike.

Pjesëmarrësit patën rastin e anketës pas trajnimit dhe raportimi në grupe për çështje të rëndësishme të hetimit dhe gjykimit të këtyre krimeve.

Përfitues të trajnimit ishin 4 gjyqtarë dhe 4 prokuror nga departamenti special, për krime të rënda, departamenti për të mitur dhe i përgjithshëm të nivelit themelor dhe të Apelit, 3 Ekspert të IT nga Policia e Kosovës si dhe 1 avokatë.



Trajnim: Shqyrtimi gjyqësor dhe gjykimi në mungesë

Më 11 tetor 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Shqyrtimi gjyqësor dhe gjykimi në mungesë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth aplikimit të dispozitave ligjore që i referohen shqyrtimit fillestar, shqyrtimit të dytë, shqyrtimit gjyqësor dhe gjyqimit në mungesë me kodin e ri të procedurës penale

Në këtë trajnim në fokus ishte elaborimi i ndryshimeve të kodit të procedurës penale që kanë të bëjnë fazën e shqyrtimit fillestar, shqyrtimit të dytë dhe shqyrtimit gjyqësor, mundësia e ngritjes së aktakuzës edhe në rastet kur i pandehuri nuk është marrë në pyetje ose nuk ka dhënë deklaratë gjatë procedurës paraprake, për shkak të arratisjes së tij.

Për secilën nga fazat e procedurës u diskutua për rolin e gjyqtarit dhe prokurorit, për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin. Vëmendje të veçantë kishte neni 334 i KPP-së si dispozitë e re ligjore që ka parashikuar mundësinë e përdorimit të drejtpërdrejtë në shqyrtim gjyqësor të marrjes në pyetje në procedurë paraprake apo deklaratës në procedurë paraprake,

nëse është vlerësuar se personat e tillë i janë nënshtruar ndërhyrjes.

U trajtua edhe gjykimi në mungesë sipas të Drejtës Ndërkombëtare. Lidhur me këtë u tha që Këshilli për Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara (UNHRC) deklaroi se Procedimi në mungesë të akuzuarve mundet në disa rrethana të jetë i lejueshëm në interesa të administrimit të duhur të drejtësisë. Pra kur personat e akuzuar janë informuar për procedurat mjaf-tueshëm por praktikisht refuzojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre për të qenë të pranishëm .

Pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit të vendime të ndryshme nga praktika gjyqësore që i referohen çështjeve të ndryshme që ndërlidhen me shqyrtimin gjyqësor si dhe në identifikimin e situatave kur mund të mbahet gjykimi në mungesë. Gjithashtu edhe diskutimit për mendimet e ndryshme juridike dhe qëndrimet parimore të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me shqyrtimin gjyqësor.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 19: gjyqtarë dhe 3 prokurorë nga niveli Themelor.



Trajnim: Veprat penale kundër mjedisit

Më 18 Tetor 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë: “Veprat penale kundër mjedisit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit dhe interpretimi dhe zbatimimi i drejtë i dispozitave përkatëse në praktikën gjyqësore të veprave penale kundër mjedisit.

Trajnimi fillimisht është fokusuar me pjesën teorike të nocioneve të ndotjes, degradimit ose shkatërrimit të mjedisit, shkatërrimit të botës bimore me materie të dëmshme si dhe shkretërimin e pyjeve. Në vazhdim është fokusuar me përkufizimin dhe elementet esenciale të veprave penale kundër mjedisit, rrethanat, mënyrat dhe format e kryerjes dhe problemet praktike me rastin e kualifikimit.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën rastin e diskutimit të rasteve nga praktika dhe në këtë

mënyrë edhe të qartësojnë dispozitat ligjore adekuate. Po ashtu si ilustrim u përdoren edhe disa raste nga praktika e GJEDNJ-së e cila pavarësisht “mungesës” të një rregullimi të përcaktuar shprehimisht për mjedisin i ka dhënë zgjidhje çështjeve përkatëse duke zbatuar në nenet e Konventës që përfshijnë rregullime të përgjithshme lidhur me mbrojtjen dhe gëzimin e të drejtave themelore duke përfshirë këtu edhe mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtën për të pasur një mjedis të pastër e cila lidhet drejtpërdrejtë me të drejtën për të gëzuar jetën private, pronën, familjen etj.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 3 gjyqtarë dhe 1 prokurorë nga niveli Themelor.



Trajnim: Praktika gjyqësore në çështjet civile, administrative dhe komerciale sipas Gjykatës Evropiane të Drejtësisë

Më 19 tetor 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Praktika gjyqësore në çështjet civile, administrative dhe komerciale sipas Gjykatës Evropiane të Drejtësisë”

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me praktikën gjyqësore në çështjet civile, administrative dhe komerciale sipas Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtua efekti dhe zbatimi i së drejtës evropiane në nivel nacional (efekti i drejtpërdrejt dhe i tërthortë), harmonizimi i të drejtës nacionale me atë evropiane - vëllimi dhe kufijtë e interpretimit gjyqësor në periudhën para anëtarësimit dhe vështirësitë (në çështje civile) si dhe zbatimi së drejtës së BE-së nga ana e gjykatave nacionale – përvojat - vëllimi dhe kufijtë e interpretimit gjyqësor në periudhën para anëtarësimit dhe vështirësitë (në çështje komerciale)

Po ashtu në këtë trajnim është elaburuar e drejta komerciale e BE-së, baza ligjore – e drejta e kompanive e BE-së, e drejta e konkurrencës e BE-së dhe traktati për komunitetin ekonomik evropian (KEE 1957), si dhe parimi i supremacisë, se si zgjidhen konfliktet në mes të drejtës së UE-se dhe te drejtës nacionale, efekti direkt i së drejtës së UE-së, efekti direkt horizontal dhe vertikal.

Pjesëmarrësit në trajnim patën mundësinë e studimit të rasteve praktike në zbatimin e parimeve dhe legjislacionit të BE-së nga gjykatat në nivel nacional në çështje administrative, civile dhe komerciale dhe përvoja e ndryshme të gjykatave nacionale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 14 gjyqtarë nga departamenti administrativ, departamenti i përgjithshëm dhe nga Gjykata Komerciale nga të gjitha nivelet.



Trajnim: Sekuestrimi dhe konfiskimi

Me 20-21 tetor 2022, n mbështetje të GIZ në kuadër të tranimeve të vazhdueshme është realizuar tryeza me temë “Sekuestrimi dhe konfiskimi”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me provat e nevojshme për zbatimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me veprë penale.

Për dy ditë me radhë fokusi i tryezës ishte në shpjegimet e hollësishme të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës në lidhje me konfiskimin, procesin e konfiskimit të aseteve të paligjshme sipas LKZK-së dhe në diskutime interaktive dhe shkëmbim të ideve dhe sygjërimeve për lëndë me potencial për konfiskim sipas legjislacionit penal përfshirë edhe Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për konfiskim.

Në tryezë është veçuar se procedura e sekuestrimit dhe konfiskimit duhet të bazohet në prova të cilat janë obligim i organeve që zbatojnë procedurën penale dhe se Konfiskimi është mjete

më i fuqishëm në luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, terrorizimit, krimeve ekonomike por edhe krimeve tjera të rënda. Vëmendje iu kushtua masave që mund të propozohen për sigurimin e pasurisë dhe cilat janë masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë, për të cilin prokurori i shtetit ka prova të artikulueshme që tregojnë dyshim të bazuar se është përdorur në veprën penale nën hetim, është provë e veprës penale nën hetim, ose është fituar nga vepra penale nën hetim.

Pjesëmarrësit patën rastin e elaborimit të disa vendimeve relevante të GjEDNj lidhur me konfiskimin e pasurisë të cilat ishin të suksesshme dhe praktikë e mirë që duhet të merret në konsideratë nga zbatuesit e ligjit.

Përfitues të kësaj tryeze ishin 7 gjyqtare (1 nga Gjykata e Apelit dhe 6 nga niveli themelor i gjykatave) dhe 5 prokuror (1 nga PRSK dhe 4 të tjerë nga niveli themelor i prokurorive)



Trajnim: Të drejtat e njeriut dhe personat me nevoja të veçanta

Me 24 Tetor 2022, në bashkëpunim me Bashkimin Evropian – EUKOJUST, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Të drejtat e njeriut dhe personat me nevoja të veçanta”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i pjesëmarrësve për të drejtat e njeriut dhe personat me nevoja të veçanta.

Trajnimi u fokusua në vështrimin e përgjithshëm mbi nevojat e veçanta me theks te korniza ndërkombëtare ligjore lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, standardet për mbrojtjen e personave me nevoja të veçanta me vështrim të posaçëm të Gjykatës Evropiane për

të drejtat e njeriut si dhe korniza ligjore në Kosovë.

Pjesëmarrësit patën rastin e studimit dhe diskutimit të rasteve të shumta ku Gjykata e Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar shkelje të drejtave të personave me aftësi të kufizuara ose që janë diskriminuar në situata të caktuara.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin 2 gjyqtarë dhe 4 prokurorë të nivelit themelor të gjykatave dhe prokurorive si dhe 4 bashkëpunëtorë profesional (1 nga Prokuroria e Apelit, 1 nga Prokuroria Themelore dhe 2 nga niveli themelor i gjykatave)



Trajnim: Shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore

Më 24 Tetor 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar një sesion i përbashkët trajnimi nga Akademia e Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës së Shqipërisë me temë: “Arsyetimi dhe shkrimi i vendimeve gjyqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me tematikën e hartimit dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

Në pjesën e paradites nga perspektiva e Shqipërisë u diskutua për strukturën dhe argumentimin e vendimeve gjyqësore për standardet kushtetuese dhe ligjore si dhe për jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Ndërkaq, në pjesën e pasdites u trajtua

arsyetimi dhe shkrimi i vendimeve gjyqësore në Kosovë dhe praktika gjyqësore si dhe në fund edhe standardet dhe arsyetimi i vendimeve të GJEDNJ-së.

Përmes këtij trajnimi të përbashkët pjesëmarrësit patën mundësinë e aspektit krahasues lidhur me standardet dhe praktikën në vendet respektive të Arsyetimit dhe shkrimit të vendimeve gjyqësore.

Përfitues të këtij sesioni ishin 12 gjyqtarë nga Kosova (2 nga Gjykata Supreme, 2 nga Gjykata e Apelit dhe 8 nga niveli themelor i gjykatave), 11 gjyqtar nga Shqipëria (2 gjyqtarë nga Apeli dhe 9 nga Gjykatat e Shkallës së I) si dhe 9 kandidatë për magjistrat.



Trajnim: Hetimi financiar

Me 24-26 Tetor 2022, në mbështetje të GIZ në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme realizuar trajnimi me temë “Hetimi financiar”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me hetimin e krimeve financiare me theks te veprat penale të korrupsionit kriminalizimi i kurrupsionit, teknikat e hetimit , hetimi i korrupsionit dhe krimi i organizuar.

Në ditën e parë të këtij trajnimi u diskutua për teknikat e hetimit të krimeve financiare, planifikimin e hetimeve, informacioni/inteligjenca/evidencat dhe burimet e informacionit si dhe për korrupsionin, teknikat e hetimit me theks te standardet ndërkombëtare dhe nga kontesti lokal.

Në ditën e dytë trajnimi u përqendrua në teknikat e hetimit të rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar me fokus te parandalimi i pastrimit të parave.

Për dy ditë me radhë pati raste studimore të korrupsionit dhe krimin të organizuar të cilët përmes ushtrimeve në grupe pjesëmarrësit kanë ofruar zgjidhjet e tyre ligjore.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Prfitues të këtij trajnimi ishin 9 prokurorë nga niveli themelor i prokurorive.



Trajnim: Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në çështje civile

Më 25 Tetor 2022, në bashkëpunim me GIZ, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar - në lëminë civile”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me tematikën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në lëminë civile.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan temat: Korniza ligjore vendore për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile; Rregulloret e BE-së për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile (Rregulloret Bruksel I, Bruksel II, Rome I si dhe rregulloret Nr. 805/2004, 1393/2007, 650/2012, 4/2009); Konventat e Hagës për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile

Në trajnim u potencua se kur flitet për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në lëminë civile kryesisht mendohet për çështjet që kanë të bëjnë me njohjen dhe përmbarimin e vendimeve të huaja gjyqësore apo vendimeve ekivalente me këto. Pra procedura për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në lëminë civile buron nga Republika e Kosovës, apo nga shtetet e huaja për Kosovën.

Po ashtu gjatë trajnimit u diskutua edhe për rastet me rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve, e rregulluar me Konventën e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës si dhe Ligjin për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës. Po ashtu janë dhënë shpjegimet lidhur me procedurën e kthimit vullnetar të fëmijës, asaj gjyqësore si dhe organet kompetente për zhvillimin e procedurës së kthimit sa ma të shpejtë të fëmijës në shtetin kërkues e në veçanti të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Ministrisë së Drejtësisë, Policisë së Kosovës dhe Qendrës për punë Sociale.

Në pjesën e fundit janë trajtuar masat e përkohshme të cilat mund të lëshohen me qëllim të sigurimit të kthimit të fëmijës si dhe rastet kur gjykata mund të refuzoj kthimin e fëmijës në shtetin kërkues.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë 64 gjyqtarë (7 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe 57 të tjerë nga niveli themelor i gjykatave) si dhe 2 zyrtarë nga Ndhima juridike Falas dhe 1 nga Ministria e Drejtësisë.



Trajnim: Masat dhe dënimet që shqiptohen ndaj të miturit

Me 25-26 tetor 2022, në mbështetje të IRZ-së në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Masat dhe dënimet që i shqiptohen ndaj të miturit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte shkëmbimi profesional dhe përvojave ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve kosovar dhe gjerman për masat dhe dënimet që u shqiptohen të miturve dhe zbatimi i praktikave më të mira në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilat rrjedhin nga Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan aspekte të rëndësishme nga Shqiptimi i masave të diversitetit dhe masave edukative; Masat dhe dënimet për të miturit me probleme psikike; Masat dhe dënimet e zbatueshme për të mitur; Veçantitë e procedurës penale për të mitur; Funkzioni i ndihmës gjyqësore për të mitur dhe shërbimit

sprovues në procesin hetimor dhe gjyqësor për të mitur si dhe në ekzekutimin e vendimit; Bashkëpunimi ndërmjet shërbimit sprovues, gjyqtarëve dhe prokurorëve si në jurisprudencën kosovare ashtu edhe nga perspektiva gjermane.

Nëpërmjet prezantimeve, rretheve të diskutimeve dhe prezantimit të rasteve nga Kosova dhe Gjermania, trajnimi ka ofruar një vështrim gjithëpërfshirës të bazave ligjore dhe praktikës.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 7 gjyqtarë kryesisht të nivelit themelor, 5 prokuror (1 nga Apeli dhe 4 nga niveli themelor i prokurorëve) si dhe 9 zyrtar nga Shërbimi Sprovues i Kosovës.



Tryezë: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorizimit dhe në rastet e dhunës në familje



Me 26-27 tetor 2022 është realizuar tryeza me temë: “ Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve në në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje”

Qëllimi i kësaj tryeze ishte identifikimi i mangësive në aspektin praktik në rastet e vendosjes për të drejtat e fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje dhe përmirësimi i praktikës së gjykatave të shkallës së parë, përmes mënyrës së duhur të vlerësimit të interesit të fëmijëve dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare.

Tryeza si fillim u përqendrua në trajtimin e aspekteve të rëndësishme që duhet pasur në konsideratë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me theks te parimet sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtarë, kriteret që merre për bazë gjykata në rastet e besimit të fëmijëve dhe parimet për përcaktimin e alimentacionit.

Në vijim është fokusuar në aspektet tjera të rëndësishme të trajtimit të rasteve të dhunës në familje siq janë urdhri për mbrojtje dhe procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje, llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre, ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrit për mbrojtje e cila më pas u vazhdua me problemet më të shpeshta të gabimeve që bëhen me rastin e vendimmarrjes dhe i praktikave jo unike nga gjykatat e instancave themelore duke ofruar zgjidhjet ligjore nga praktika e GJEDNJ-së në rastet e tilla nga kontestet familjare.

Nga diskutimet e panelistëve me pjesëmarrës ka rezultuar në këto rekomandime:

Të krijohen standarde të të provuarit në secilën çështje, në mënyrë që gjyqtarët ta kenë të qartë se në bazë të cilave kriteret apo standarde të vlerësimit të provohet një fakt i caktuar

Të sigurohet një listë e ligjeve të aplikueshme në Kosovës për shkak të sfidave që kanë gjyqtarët dhe profesionistët tjerë ligjorë në drejtim të identifikimit të ligjeve të aplikueshme, pasi ka zbatim të shumë ligjeve dhe rregulloreve të sistemeve të ndryshme (sistemi para vitit 1989, sistemi pas 1989 që nuk kanë karakter diskriminues, rregulloret e UNMIK-ut pas luftës dhe Ligjet pas vitit 2008),

Të sigurohen që Konventat që janë të numëruara në Kushtetutë e që gjejnë zbatim të drejtpërdrejt në Kosovë, por edhe dokumentet tjera ndërkombëtare të sigurohen për gjyqtar në gjuhën shqipe,

Të sigurohet një data bazë ku gjyqtarët do të kenë mundësi të kenë qasje të drejtpërdrejt, në ligje, konventa, dokumente tjerë ndërkombëtar akte nënligjore,

Të vazhdohet me tryeza të tilla sepse do të jenë më të efektshme sesa trajnimet klasike, por të ju llogaritet prezenca në tryeza sikurse në trajnime gjyqtarëve,

Me rastin e zbatimit në praktikë gjykatat e shkallës së parë duhet me qenë më aktive në kontestet familjare me të vetmin qëllim që vendimi me qenë më i drejtë dhe në interes të fëmijëve,

Me rastin e vlerësimit të interesit të fëmijëve gjykatat duhet të vlerësojnë drejtë këtë interes duke u nisur nga dy komponentët e saj komponenti emocional dhe atë financiar, por që të dominon ai emocional,

Me rastin e hartimit të vendimeve që i referohen vërtetimit të interesit të fëmijëve, ky interes të jetë në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga vendimet e GJEDNJ-së që i referohet vendim-marrjes në raport me këto konteste.

Përfitues të kësaj tryeze ishin 16 gjyqtarë (2 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, 2 gjyqtarë nga

Gjykata Supreme dhe 12 të tjerë nga niveli themelor i gjykatave nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Trajnim: Liria e shprehjes dhe liria e mediave

Me 27 tetor 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme dhe në mbështetje të Këshillit të Evropës, përkatësisht projektit JUFREX është realizuar tryeza për regjionin e Mitrovicës me temë: “Lirinë e shprehjes: shpifja dhe mbrojtja e reputacionit dhe siguria e gazetarëve”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte zhvillimi i shkath-tësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mbrojtjen gjyqësore në rastet e shkeljes së të drejtave të qytetarëve dhe në veçanti liria e shprehjes dhe në rastet e shpifjes dhe vendosja meritorë e rasteve përkatëse..

Tryeza për dy ditë me radhë ka trajtuar konceptet themelore të lirisë së shprehjes dhe medias, shpifjen dhe mbrojtjen e reputacionit bazuar në standardet e GJEDNJ-së, pastaj mekanizmat tjerë për mbrojtje me fokus te roli

i Komisionit të Pavarur për Media dhe Këshillit të Mediave të shkruara, për sigurinë e gazetarëve të cilat janë shoqëruar me raste nga praktika gjyqësore vendore dhe ajo e GJEDNJ-së. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe zhvillimeve të fundit të Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjatë tryezës janë përdorur metoda interaktive, ku ka patur diskutime dhe pyetje nga pjesëmarrësit.

Përfitues të tryezës ishin 1 gjyqtarë, 1 prokurorë si dhe 3 bashkëpunëtorë profesional nga Gjykata dhe Prokuroria Themelore në Mitrovicë.



Trajnim: Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve për akuzat dhe dënimet e rasteve të dhunës në familje

Më 28 Tetor 2022, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Bashkimin Evropian – EUKOJUST, kanë realizuar trajnimin me temë: “Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve për akuzat dhe dënimet e rasteve të dhunës në familje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët merren me rastet e dhunës në familje në ngritje të aktakuzave dhe dënimin e rasteve të dhunës në familje në procedurë penale në proporcion me peshën e krimit në përputhje me standardet ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare.

Në pjesën e parë të trajnimit është diskutuar rreth standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, duke përfshirë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) për dënimin e rasteve të dhunës në familje.

Ndërsa në pjesën e dytë është diskutuar për vlerësimin e rasteve të dhunës në familje duke marrë parasysh natyrën specifike, mënyrën e zhvillimit të ndjekjes penale, aktgjykimin dhe dëmshpërblimin, duke shtjelluar vlerësimin e formave të ndryshme të rrethanave lehtësuese dhe rënduese që do të ndikojnë në shqiptimin e dënimit ndaj kryerësve dhe në nxjerrjen e aktgjykimeve në rastet e dhunës në familje duke përfshirë formën e tyre.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën rastin e diskutimit të rasteve.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 1 gjyqtar dhe 2 prokuror si dhe 5 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës.



Aktivitetet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Trajnim: Menaxhimi i kohës dhe stresit

Me 10 tetor 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme për stafin administrativ të gjykatave është realizuar trajnimi me temë: “Menaxhimi i Kohës dhe Stresit”.

Qëllimi i trajnimit ishte që stafi administrativ i Gjykatave dhe Prokurorive të fitojnë njohuri bazike rreth formave të manifestimit të stresit dhe menaxhimit të tij.

Gjatë trajnimit u diskutuan llojet e stresit, mënyrat e përbaljes me stresin dhe tejkalimit të tij, shenjat fillestare të stresit, etj.

Gjithashtu në mënyrë interaktive mes trajnuesit dhe pjesëmarrësve u diskutuan edhe pasojat e stresit në punë, pasojat e stresit në shëndet, si dhe strategjitë më të mira të administrimit të kohës në mënyrë sa më efektive.

Përfitues të trajnimit ishin 13 zyrtarë administrativ të gjykatave dhe prokurorive nga të gjitha regjionet e Kosovës. Prej tyre 6 nga gjykatat dhe 7 nga prokuroritë e nivelit themelor.



Trajnim: Trajnimi për mbrojtjen e sinjalizuesve

Më 27 dhe 28 tetor 2022, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës – Projekti i JUFREX, ka zhvilluar trajnimin për stafin administrativ të Gjykatave dhe Prokurorive, me temë: “Mbrojtja e Sinjalizuesve”.

Ky trajnim ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm të AD-së me projektin e JUFREX, në zhvillimin e trajnimeve rreth Lirisë së shprehjes dhe mediave, si dhe mbrojtjes së Sinjalizuesve.

Pjesëmarrësit patën mundësinë që gjatë trajnimit dy (2) ditor, të përfitojnë njohuri rreth Sinjalizimit dhe ndërlidhjes së tij me lirinë e shprehjes, legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar rreth sinjalizimit, dallimet mes sinjalizimit në sektorin publik dhe privat, Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe kriteret e saj për vlerësimin e rasteve të sinjalizimit etj.



Gjithashtu u trajtuan edhe Instrumentet e Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian për mbrojtjen e sinjalizuesve, zbatimi në praktikë i standardeve të GJEDNJ-së, Rregullorja (grk) - nr. 03/2021 për përcaktimin dhe procedurave për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit.

Përveç dy trajnuesve të angazhuar nga AD, Gjyqtari Dren Rogova dhe ekspertja vendore Flutura Kusari, trajnimi u pasurua edhe me përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsion, të cilët e shfaqën mënyrën e mbrojtjes së sinjalizuesve edhe nga ana praktike nga Institucioni i tyre.

Përfitues të trajnimit ishin 14 Zyrtarët për Sinjalizim brenda Gjykatave dhe Prokurorive nga të gjitha regjionet e Kosovës.




Vijueshmëria në trajnim në PTF përmes grafikoneve




Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve

Numri i pjesëmarrjes në trajnime në bazë të Institucioneve - Tetor 2022




Numri i pjesëmarrjes dhe trajnimeve të realizuara sipas fushës -Tetor 2022




Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve


Numri i pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara -Tetor 2022




Pjesëmarrja sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike -Tetor 2022



Nr. i trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive -Tetor 2022



Vijueshmëria në trajnime përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660